



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 07/2025

I Mbajtur në takimin e VII-të të rregullt të KPF-së me datën 29.07.2025, në sallën e e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025;
5. Propozim – Vendim për shkëputjen e Marrëveshjes së Bashkpunimit me Agjensinë për Zhvillimin Rajonal – Lindje “AZHR” të datës 16.12.2008, në mes komunave duke përfshirë edhe Komunën e Ferizajt;
6. Propozim –Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr.01. Nr.109 të datës 30.09.2019, i plotësuar – ndryshuar sipas Vendimit me Nr. 01.Nr. 22 të datës 28.03.2025;
7. Propozim –Vendim për aprovimin e memorandumit të bashkëpunimit me OJQ-të, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj;
8. Propozim – Vendim për pezullimin e Vendimeve me Nr.01. Nr. 48, 49,50,51,52,53,56 të datës 30.05.2025 dhe anulimin e Vendimit me Nr.01.Nr. 55 të datës 30.05.2025;
9. Propozim – Vendim për Subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik dhe
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Xhavit Zariqi e hapi mbledhjen e KPF-së në ora: 10:10 dhe pasi lexoi pikat e lartcekura i pyeti të pranishmit nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës:

Pasi nuk pati u miratua rendi i ditës me 7 vota për.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit, fjalën e mori Mimoza Pajaziti e cila potencoi se tek procesverbali i Kuvendit ka vërejte, pasi fjala e saj ishte gjysmake në disa raste, Kryesuesi i Kuvendit e ritheksoi se këtu jemi në mbledhje të KPF-së dhe po miratojmë procesverbalin e KPF-së, andaj pyetja ime është a ka dikush diçka rreth procesverbalit të KPF-së, pasi nuk pati kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4-të që ishte raporti financiar pasi nuk pati të interesuar për diskutim kaloi edhe kjo pikë për kuvend me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të dhe ia kaloi fjalën Balton Dergutit, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se kjo marrëveshje është themelu në Vitin 2008 me kërkesë të BE-së, është themelu me kërkesë dhe në atë kohë kanë qenë 5 regjione, ku Ferizaj atë botë ka mbetë nën regjion të Gjilanit dhe realisht tanimë aty janë një dy zyrtar ku realisht i shërbejnë vetëm asaj komune.

Unë si drejtor kam kërku që të themelohet një AZHR në Ferizaj pasi tanimë jemi edhe regjion andaj unë më duhet të ju njoftoj që kjo anëtarësi kushton rreth 9,500.00 euro, dhe realisht nuk marrim asnjë shërbim dhe si rrjedhojë ne kemi kërkuar që të themelohet në Ferizaj dhe deri sa të themelohet propozojmë të shpërbëhet kjo marrëveshje me AZHR lindje.

Arian Imeri kam pyetje që këta zyrtar janë si ndërmjetësues dhe realisht a mundemi që këto marrëveshje eventuale t'i lidhim edhe pa këta zyrtar.

Kryesuesi e hodhi për votim dhe kjo pikë kaloi për kuvend me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim..

Kryesuesi e lexoi pikën e 6-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ky propozim ka të bëjë me qiran e pensionistëve dhe me ndryshimin e vendimit po hezitojnë mi pagu ato 4 qira dhe me këtë plotësim do ta obligojmë drejtorinë edhe për ato 4 qira.

Kryesuesi e hodhi për votim dhe kjo pikë kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7-të dhe ia kaloi fjalën përsëri Drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se ky propozim është miratua, mirëpo ka pas klauzolë të dhënies në shfrytëzim dhe si i tillë është refuzu, ndërsa tash ka fond nga OJQ-të për ristrukturim ku rastet referohen nga gjykata dhe QPS andaj këtë rast komuna e monitoron si shërbimin.

Kryesuesi e hodhi për votim dhe kjo pikë kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8-të dhe fjalën e mori përsëri Sabri Murseli i cili theksoi se këto vendime pezullohen deri sa të krijohen kushte, ndërsa vendimi Nr. 55 pala ka kërku tërheqjen e kërkesës dhe ka kërkuar që të anulohet.

Flamur Istrefi pyeti cila është prona që pala është terjek, ku drejtori u përgjigj se nuk e di pasi s'kam qenë në atë seancë. Dhe kjo pikë kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 9-të dhe fjalën ia kaloi Drejtorit Alberton Sahiti i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se kemi vendosur të subvencionojmë transportin ashtu si e lejon edhe ligji, d.m.th. për transport urban dhe urbano periferik dhe kemi dy subvencione ku për transport urban është 0.40 cent, ndërsa për urbano periferik çmimi do të jetë 0.30 dhe kemi paraparë disa kategori në transport urban falas si janë nxënës, invalid e kategori të dala nga lufta ndërsa në atë urbano periferik do të jetë 30% zbritje dhe këtë model e ka edhe Prishtina andaj besoj që do të del mirë.

Kryesuesi e falënderoj për fjalën drejtorin dhe pyeti nëse dëshiron dikush të merr fjalën :

Brahim Osmani i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se sa i përket këtij propozimi mendoj që nuk duhet me u ba fare, pasi kur u propozu u dasht prej fillim me ba, e jo nëherë me i qit kompanitë me provu, e mandej me kqyrë me sa me miratu, andaj unë edhe prej fillimit jam kanë kundër pasi që 0.40 cent, nuk është diçka që ja vlen, pasi është e pa pranushme për qytetart , e dyta se dimë cilat kompani janë që e kanë përfitu tenderin dhe e treta kush e formon këtë komision se sipas qeti vendimi s'dihet kush qysh tek.

Flamur Istrefi fillimisht këtu s'kemi informacion se kemi as çmimin se sa km kanë mi ba d.m.th. kjo kështu ska logjik, mirëpo në propozim sipen detajet, as sa është periudha për sa kohë, përndryshe këto çmime që janë unë këtë formë se mbështesë, unë jam për subvencionim po jo për këtë formë.

Lumnije Morina pasi përshëndeti të pranishmit nëse e keni marr modelin e Prishtinës ajo e ka 0.80 cent, e ka tan ditën nëse e keni marr atë model, kjo nuk o kështu pasi ju e keni llogarit për km, qysh o kjo kështu a mundesh me na skjaru.

Drejtori theksoi se varësisht sa është vija qarkulluese do të subvencionohen ata që kanë vijë të regjistruar në komunë dhe çmimi do të jetë sipas rendit të udhëtimit dhe km që bëjnë në vijat prej stacionit deri në stacion të fundit dhe kthimi normal.

Normalisht që si fillim do të jetë problem, mirëpo po pretendojmë ta rregullojmë sa më shpejt që është e mundur.

Kryesuesi theksoi që me këtë çmim edhe me këto kategori që do të lirohen, nuk besoj që do të ketë interes asnjë kompani për të apliku.

Mimoza Pajaziti theksoi që çdo fillim i ka sfidat e veta bile unë jam për me i liru edhe mësimdhënësit pse jo, unë jam pro këtij propozimi, Kryesuesi ani Mimoza po lëshojmë fal, Arian Imeri mësimdhënësi merr pagë bre pse me subvencionu...(kishte bashkëbisedim të përzier)...

Kryesuesi pasi e mbylli debatin për këtë pikë e hodhi në votim për të ta kaluar dhe për ta proceduar në kuvend, e aty e vazhdojmë debatin për këtë pikë edhe drejtori vjen me propozime ma konkrete.

Kjo pikë kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.


Kryesuesi tek të ndryshme, a ka për të diskutuar, mbasi nuk pati e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

